

Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës me auditim paralel në fushën IT për sistemet e informacionit të ujësjellësve

Në datat 9-10 qershor 2022, një delegacion i përbërë nga 3 auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Benard Haka, kryeauditues, znj. Elira Cukalla, audituese e lartë dhe z. Blerin Shkurti, auditues i I, zhvilluan një vizitë pune parapërgatitore në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.



Në fokus të vizitës ishte diskutimi mbi zhvillimin e një auditimi paralel në fushën IT për sistemet e informacionit të ujësjellësve në të dyja vendet.

Gjatë qëndrimit në ZKA grupet e përbashkëta të auditimit zhvilluan disa sesione pune lidhur me prezantimin e eksperiencave dhe sistemeve respektive të informacionit të përdorura në të dyja vendet, si dhe shkëmbyen ide dhe qasje lidhur me metodat dhe objektivat e auditimit paralel në këtë fushë.

Grupi i audituesve të KLSH-së u prit në një takim dhe nga Auditorja e Përgjithshme e Kosovës. Znj. Vlora Spanca e cila vuri theksin në rëndësinë e intensifikimit të marrëdhënieve dy palëshe, ashtu siç është edhe dakordësuar më parë ndërmjet Auditorës së Përgjithshme dhe Kryetarit të KLSH-së, duke e materializuar këtë bashkëpunim edhe nëpërmjet hapave konkretë si auditimi paralel i parashikuar të zhvillohet së shpejti.